



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr.712/7 Prot.

Tiranë, më 17.08. 2026

V E N D I M

Nr.222, Datë 17.08. 2026

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O N:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe bazuar në informacionin e marrë gjatë transmetimit të emisionit “Living Day”, më datë 03.10.2025, në Televizionin Vizion Plus³ dhe emisionit “Studio Live”, më datë 10.12.2025, në Televizionin Report⁴, lidhur me gjuhën e përdorur nga z. Z. I kundrejt personave që i përkasin komunitetit LGBTI, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁵, me urdhrin nr. 151, datë 17.12.2025, filloi procedurat hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me gjuhën e përdorur nga z. Z. I ndaj personave LGBTI, të bëra në këto media audiovizive.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, me vendimin nr.83, datë 14.04.2026, Komisioneri ka disponuar në lidhje me çështjen, duke vendosur:

- Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, si pasojë e gjuhës së përdorur nga z. Z. I në emisionin “Living Day”, të datës 03.10.2025, transmetuar në Televizionin Vizion Plus dhe emisionin “Studio Live”, të datës 10.12.2025, transmetuar në Televizionin Report Tv.
- Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

³ <https://www.youtube.comxxxxxxx>

⁴ <https://www.youtube.com/xxxxxx>

⁵ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

seksit, si pasojë e përhapjes nga ana Televizionit Vizion Plus/Shoqërisë Media Vision sh.a dhe Televizionit Report Tv/Shoqërisë MTSC sh.p.k, të gjuhës së urrejtjes së përdorur nga z. Z. I , sipas pikës 1, të këtij vendimi.

- Në referim të pikës 1 të këtij vendimi z. Z. I , në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
- Në referim të pikës 2 të këtij vendimi, Televizioni Vizion Plus/Shoqëria Media Vision sh.a dhe Televizioni Report Tv/Shoqëria MTSC sh.p.k, duhet të marrin masat e mëposhtme:
 - a. Të bëjnë një deklaratë publike me anë të të cilës distancohen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI.
 - b. Të marrin masa për heqjen e deklarimeve të përbëjnë gjuhë urrejtje, nga përmbajtja e emisionit “Living Day”, të datës 03.10.2025, transmetuar në Televizionin Vizion Plus dhe emisionit “Studio Live”, të datës 10.12.2025, transmetuar në Televizionin Report Tv, të publikuar në kanalet e tyre respektive zyrtare në rrjetin social youtube⁶.
- Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, z. Z. I , Televizioni Vizion Plus/Shoqëria Media Vision sh.a dhe Televizioni Report Tv/Shoqëria MTSC sh.p.k, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
- Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar se, z. Z. I ka marrë dijeni për vendimin në datën 21.04.2026.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se : “11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon

⁶ <https://www.youtube.com/xxxxxxxxxx>

⁶ <https://www.youtube.com/xxxxxxxxxxl>

komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.”

Në kundërshtim me nenin 33, pika 11, të LMD, z. Z. I nuk raportoi pranë Komisionerit brenda afatit ligjor 30 ditor, në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Me shkresën nr.712/5 prot, datë 29.07.2026, Komisioneri kërkoi nga z. Z. I informacion mbi plotësimin e masave të dhëna me vendimin nr.83, datë 14.04.2026. Në vijim, z. Z. I, ktheu përgjigje, e cila u administrua pranë Komisionerit me nr.712/6 prot., datë 10.08.2026, duke informuar se, nuk ka paraqitur dhe nuk ka ndërmend të paraqesë asnjë deklaratë publike për kërkim ndjese, pasi nuk konsideron së deklaratat e tij përbëjnë gjuhë diskriminuese, nxitje urrejtje apo thirrje për dhunë ndaj asnjë individi apo grupi personash.

Sa më sipër, rezulton e provuar se, z. Z. I , në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka zbatuar vendimin nr. 83, datë 14.04.2026, të Komisionerit. Në këtë mënyrë, z.Z. I , nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 11, të ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat fizikë, siç është në rastin konkret z. Z. I , në nenin 33, pika 13, germa “a” të ligjit 10221/2010 parashikohet se : “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”: a) personi fizik, nga 10 000 deri në 60 000 lekë;”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, z. Z. I , është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës Komisioneri, arrin në përfundimin se, z. Z. I , duhet të gjobitet me 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.52, datë 06.03.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç”, nenin 33, pikat 11, 12, 13, germa “a”, 14 dhe 18, si dhe nenin 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Z. Z. I , të gjobitet në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.83, datë 14.04.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoha të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr.83, datë 14.04.2026, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)